



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



KONKURS PËR PRAKTIKANTË

Komuna e Prishtinës shpall konkurs për **4 praktikantë nga Universiteti i Prishtinës** për periudhën 1 Tetor 2017 – 31 Janar 2018. Praktikantët do të kompensohen me një bursë mujore e cila do të jetë në lartësi prej **100 euro**.

Aplikantët e sukseshëm do të sistemohen në Komunën e Prishtinës dhe do të angazhohen në Drejtorinë e Sherbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Kushtet për aplikim :

- Student i Fakultetit Juridik, ekonomik
- Vit i fundit i studimeve ose i sapo diplomuar,
- Njohuri për Komunën e Prishtinës,
- Aftësi të mira komunikuese, me shkrim dhe me gojë,
- Njohja e gjuhës angleze e preferueshme

Aplikantët e sukseshëm duhet të paraqesin :

- një letër motivuese,
- CV/Resume dhe çertifikatën e diplomës apo diplomën,
- dokumentacioni i pakompletuar nuk merret parasysh.

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS

- Pranimin e lëndëve për shfrytëzimin e hapësirave publike nga shfrytëzuesit dhe shqyrtimi i tyre në bashkëpunim me zyrtarët;
- Në bazë të kërkesës së subjekteve të kryhen matjet në teren për vendosjen e reklamave, gjeneratorëve dhe hapësirave tjera publike;
- Të ndihmojnë zyrtarët në evidentimin dhe formimin e Administratorëve në bazë të ligjit për banim në bashkëpronësi.
- Kryejnë edhe detyra të tjera në bazë të vendimit të shefit të Sektorit dhe drejtorit të Drejtorisë;

Në intervistë me gojë, ftohen vetëm aplikantët nga lista e ngusht, e cila hartohet mbi bazën e kriterëve të konkursit dhe letrës motivuese.

Aplikacionet dërgohen në adresën elektronike mimoza.llapashtica@rks-gov.net ose në zyrat e Sektorit të Burimeve Njerëzore (Ndërtesa e vjetër e Komunës, kati i II, nr. 40), Rr. UÇK-2 Prishtinë, më së largu deri më 15 Shtator 2017, ora 16:00.